



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1754 prot.

Tiranë, më 13 . 11 . 2019

Lënda: Sugjerime mbi projekt-ligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

Z. ULSI MANJA
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT
KUVENDI I SHQIPËRISË

Për dijeni:

Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar z. Manja,

Në vijim të kërkesës Tuaj, për të dhënë opinion në lidhje me projektligjin “Për Policinë e Burgjeve”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua me këtë projekt-ligj, sugjeron si më poshtë:

I. Riformulim i nenit 6 pika 1 të projektligjit

Dispozita aktuale në projektligj: Referuar përmbajtjes së këtij projektligji, Kreu II “Parimet e organizimit dhe Funksionimit të Policisë së Burgjeve”, Seksioni I “Parimet e Ushtrimit të veprimtarisë”, neni 6, pika 1 parashikon shprehimisht se:

Neni 6 - Objektiviteti dhe barazia

“Policia e Burgjeve siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat e dënuar dhe të paraburgosur, pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore,

predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”.

Rekomandimi KMD:

Përsa më lart, sugjerojmë të riformulohet pika 1 e nenit 6 të projektligjit dhe titulli i nenit 6, me përmbajtje si vijon:

Neni 6 - Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

“Policia e Burgjeve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, vepron në përputhje me parimin e barazisë dhe shmang çdo diskriminim të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim për çdo shkak të parashikuar në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Arsyetimi: KMD vlerëson se është shumë e rëndësishme që veprimtaria e Policisë së Burgjeve të ushtrohet në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si një ndër parimet më të rëndësishme që thekson rëndësinë e këtij funksioni dhe ushtrimin e tij me profesionalizëm dhe në respektim të plotë të misionit të Policisë së Burgjeve dhe të trajtimit me dinjitet të personave me kufizim lirie.

Nga sa është formuluar në këtë projektligj, sjellim në vëmendje se, bazuar edhe në literaturën juridike, parim i barazisë dhe mosdiskriminimit qëndron më vete nga parimi i paanësisë dhe objektivitetit. Gjithashtu, termi “paragjykim” nuk duhet ngatërruar dhe vendosur në vend të diskriminimit, i cili përkthehet në veprime konkrete dhe aktive.

Ndaj KMD evidenton nevojën për riformulimin e këtij parimi me qëllim që të jetë sa më i saktë dhe i përafëruar plotësisht me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

II. Zëvendësimi i nenit 6 pika 2 të projektligjit

Dispozita aktuale në projektligj: Referuar përmbajtjes së këtij projektligji, Kreu II “Parimet e organizimit dhe Funksionimit të Policisë së Burgjeve”, Seksioni I “Parimet e Ushtrimit të veprimtarisë”, neni 6 “Objektiviteti dhe barazia”, pika 2 parashikon shprehimisht se:

“Punonjësit e Policisë së Burgjeve ushtrojnë trajtim favorizues ndaj grave, të miturve dhe personave të tjerë, që kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë.”

Rekomandimi KMD:

Përsa më lart, sugjerojmë të zëvendësohet neni 6, pika 2 e projektligjit, me përmbajtje si vijon:

“Ndalimi i diskriminimit, i përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.”

Arsyetimi: Trajtime të veçanta dhe favorizuese, që i përgjigjen nevojave specifike apo rasteve të veçanta dhe që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të të paraburgosurve dhe të dënuarve që bëjnë pjesë në grupe të veçanta dhe të identifikuar shprehimisht në ligj, si: gratë, nënat, të miturit, personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, etj, rregullohen me Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i cili gjithashtu po reformohet në kuadër të kësaj nisme dhe KMD po përgatit mendimet dhe sugjerimet e tij konkrete).

Ndaj KMD vlerëson se ky parashikim nuk është i përshtatshëm për tu parashikuar në dispozitat e parimeve të ushtrimit të veprimtarisë për Policinë e Burgjeve dhe duhet zëvendësuar me një parashikim që vjen në harmoni me sugjerimet e mësipërme të nenit 6, paragrafi 1.

Lidhur me këtë të fundit, sqarojmë paraprakisht se, diskriminimi është diferenca në trajtim bazuar në një nga shkaqet e mbrojtura, për të cilën nuk ka një përligje objektive dhe të arsyeshme. Pra, jo çdo diferencë në trajtim përbën diskriminim, por vetëm ajo që nuk ka një përligje objektive dhe të arsyeshme. Diferenca në trajtim për të cilën ka një përligje objektive dhe të arsyeshme, nuk përbën diskriminim dhe nuk është e ndaluar nga ligji.

III. Ndalimi i kontrollit të korrespondencës të personave e dënuar me burgim apo të paraburgosurve me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Dispozita aktuale në projektligj: Në Nenin 12 të projektligjit “Përgjegjësitë e Policisë së Burgjeve”, pika 2, germa (dh), parashikohet shprehimisht se:

“2. Përveç detyrave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve ushtron funksionet e mëposhtme:

dh) Kontrollon korrespondencën e personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve, përveç asaj të shkëmbyer me Avokatin e Popullit, avokatët mbrojtës apo organizmat ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave të njeriut;”

Rekomandimi KMD:

Sa më lart, sugjeroj që në Nenin 12, pika 2, germa (dh), të shtohet institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një ndër aktorët me të cilët ndalohet kontrolli i korrespondencës të personave e dënuar me burgim nga Policia e Burgjeve, sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Përveç detyrave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, struktura e posaçme e Policisë së Burgjeve ushtron funksionet e mëposhtme:

dh) Kontrollon korrespondencën e personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve, përveç asaj të shkëmbyer me Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, avokatët mbrojtës apo organizmat ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave të njeriut;”

Arsyetimi: Duke qenë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi, nëpërmjet asistencës së viktimave të mundshme të diskriminimit dhe trajtimit të ankesave individuale përmes një procedure administrative, dhe duke patur parasysh edhe raste të mëparshme të KMD të trajtimit të ankesave me persona të dënuar me burgim, sugjerojmë që të shtohet gjithashtu, ndalimi i kontrollit të korrespondencës së personave të dënuar me burgim apo të paraburgosurve, të shkëmbyer me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

IV. Heqjen e pikës 1 dhe 2 të nenit 22 lidhur me të drejtat politike

Në Nenin 22 të projektligjit “Të drejtat politike”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Policia e Burgjeve funksionon si një strukturë e depolitizuar.*
- 2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk mund të jetë anëtar i partive politike.*
- 3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, përveçse në rastet që nuk lidhen me kohën dhe ushtrimin e funksioneve publike.*

Rekomandimi KMD:

Sa më lart, sugjerojmë që pika 2 e nenit 22 të projektligjit të hiqet.

Arsyetimi: Bindjet politike të punëmarrësit janë një e drejtë e tij, e lirë për t’u ushtruar sa kohë nuk ndikojnë në rregullsinë e përmbushjes së detyrimeve të tij kontraktore, në funksion të detyrës së ushtruar dhe gjatë kohës së saj.

V. Heqja e kufizimit të moshës në kriteret për pranimin ne Policinë e Burgjeve

Dispozita aktuale në projektligj: Në Nenin 29 të projektligjit, pika 1,germa (ë), parashikon shprehimisht se:

*“1. Ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar në Policinë e Burgjeve çdo person që plotëson kriteret e mëposhtme:
ë) Është nën moshën 35 vjeç;”*

Rekomandimi KMD:

Sa më lart, sugjerojmë që Neni 29 i projektligjit, pika 1, germa (ë), të shfuqizohet, nëse nuk ka një justifikim objektiv.

Arsyetimi: Kriteri i vendosur në këtë rast, sipas të cilit kufizohet për shkak të moshës, rekrutimi dhe përzgjedhjen e punonjësve të Policisë së Burgjeve, në pamje të parë përbën diskriminim,

nëpërmjet përjashtimit, për shkak të moshës, të personave që aspirojnë të punojnë pranë Policisë së Burgjeve dhe që janë mbi 35 vjeç. Nëse ky kriter “justifikohet” për shkak të natyrës së aktivitetit profesional dhe se kjo përbën një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj, nuk përbën diskriminim.

Në relacionin shoqëruar të projekt-ligjit, për këtë dispozitë, nuk thuhet arsyeja se përse është parashikuar një kriter i tillë. Konkretisht, në relacion thuhet: “Neni 29 përcakton kriteret e përgjithshme të hyrjes në profesion, që do të duhet t’i përmbushin të gjithë personat që aspirojnë të punojnë pranë Policisë së Burgjeve. Projektligji përcakton edhe balancimin e raportit ndërmjet burrave dhe grave, duke krijuar një standard të ri në sistemin e burgjeve.”

Në vlerësimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kufizimi i moshës për pranimin në Policinë e Burgjeve duhet hequr. Në të kundërt, kjo kërkesë profesionale, duhet të jetë vërtetë e domosdoshme, objektivist e justifikueshme dhe proporcionale, pra kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

VI. Parashikimi i trajnimeve specifike për grupe të specifike

Dispozita aktuale në projektligj: Në Nenin 29 të projektligjit, pika 1,germa (ë), parashikon shprehimisht se:

“2. Pas emërimit në pozicionin përkatës, punonjësi i Policisë së Burgjeve detyrohet të ndjekë trajnimin vazhdues të përmirësimit të aftësive profesionale të Policisë së Burgjeve, në përputhje me rregulloren e personelit.”

Rekomandimi KMD:

Sa më lart, sugjerojmë që ne nenin 30 të projektligjit, të shtohet një paragraf dhe të formulohet me përmbajtje si vijon:

“2. Pas emërimit në pozicionin përkatës, punonjësi i Policisë së Burgjeve detyrohet të ndjekë trajnimin vazhdues të përmirësimit të aftësive profesionale të Policisë së Burgjeve, në përputhje me rregulloren e personelit. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët punojnë me grupe specifike të të dënuarve, siç janë të miturit, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të huajt etj, duhet të marrin trajnime dhe kualifikime të veçanta, në fushat përkatëse.”

VII. Te hiqet kriteri diskriminues për lirim nga detyra i Drejtorit të Policisë së Burgjeve

Dispozita aktuale në projektligj: Në Nenin 53, pika 2 germa (a) të projektligjit parashikohet shprehimisht se:

*“2. Drejtori i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra për këto arsye:
a) Është i paaftë nga ana shëndetësore, për një periudhë deri në 6 muaj”*

Rekomandimi KMD:

Sa më lart, sugjerojmë që neni 53, pika 2 germa (a) i projektligjit, të ndryshohet si më poshtë:

*“2. Drejtori i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra për këto arsye:
a) Është në pamundësi për të ushtruar funksionin për më shumë se 6 muaj”*

Arsyetimi: Fillimisht, termi “i paaftë” nuk mund të përdoret me në aktet ligjore që miratohen, pasi vjen në kundërshtim me konceptet e Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” dhe legjislacionin në fuqi. Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” ka vendosur detyrimin për institucionet përgjegjëse, të cilat bazuar në këtë ligj, duhet të ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ROBERT GAJDA

KOMISIONERI